



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 84, datë 26.07.2022

PËR

MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN 1, BASHKËLIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 34, DATË 09.05.2022, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.122, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.4, RRUGA “ALEKSANDËR GOGA, I DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të proçesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr.164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komsionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e proçesit të rindërtimit", i ndryshuar, Raportit me nr. 471/40 prot., datë 15.07.2022 të Komisionit të Posaçëm miratuar nga kryetari i bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e një shtese në aneksin 1, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 34, datë 09.05.2022, përsa i përket listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin Nr. 122, në Njësinë Administrative nr. 4, Rruga “Aleksandër Goga”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, sipas tabelës si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATËS	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
30	QEMAL VATHI	4	2+1

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.07.2022

BASHKIA DURRES
D. 11.08.22 Nr. 5948/5



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRES**

Nr. 631 / prot.
5

Durrës, më 10 08 .2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRES**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRES**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.84 datë 26.07.2022

Për miratimin e një shtese në aneksin 1, bashkëlidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 34, datë 09.05.2022, përsa i përket listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr.122, në njësinë administrative nr.4, rruga “Aleksandër Goga, i dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI